



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI**

V E N D I M

**PËR
AUDITIMIN TEMATIK TË USHTRUAR NË
AGJENCINË KOMBËTARE TË BARNAVE DHE PAJISJEVE MJEKËSORE
“AUDITIM PËRPUTHSHMËRIE”,
për periudhën nga data 01.11.2018 deri më datën 31.08.2020**

Nga “Auditimi tematik i përputhshmërisë” i ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, për periudhën 01.11.2018 deri më 31.08.2020, rezultuan mospërputhje në veprimtarinë administrative ndaj kriterëve të vlerësimit, përfshirë kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, që lidhen dhe ndikojnë në sigurinë dhe shëndetin e qytetarëve si dhe përdorimin me efikasitet, ekonomikitet dhe efikasitet të fondeve shtetërore.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Institucioneve Qendrore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga, Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

VENDOSA:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit Tematik, “Mbi Përputhshmërinë” të ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, sipas programit të auditimit nr. 812/1 prot, datë 01.09.2020, i ndryshuar, për veprimtarinë nga data 01.11.2018 deri më datën 31.08.2020.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon;

**A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË
LEGJISLACIONIN NË FUQI**

1- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, baza rregullative mbi të cilën bazohet veprimtaria e institucionit paraqet mangësi. Sipas bazës ligjore aktuale, konkretisht VKM nr. 24, datë 14.01.2015, i ndryshuar, ka përcaktuar që kompetencën për miratimin Rregullores së Brendshme e ka Titullarit i institucionit i cili me Urdhrin nr. 264 datë 25.09.2017 e ka miratuar atë, ndërkohë sipas VKM-së së mësipërme dokumenti “Përshkrimet e Punës” duhet të propozohet nga Drejtori i AKBPM dhe të miratohej nga ministri përgjegjës për shëndetësinë. Përshkrimet e punës janë përcjellë zyrtarisht pranë ministrisë përgjegjëse me shkresën nr. 3212 prot, datë 08.05.2017 por ende nuk ka një miratim zyrtar apo shkresë për rregullim apo plotësim të tyre nga kjo e fundit. Pra aktualisht AKBPM nuk disponon një ndarje të detajuar të punës, çka ndikon dhe në ndarjen e qartë të përgjegjësiave individuale për institucionin në tërësi. Kontradiktore paraqitet situata ku sipas VKM-së nr. 24, përcaktohet se, “Rregullorja e Brendshme e Funksionimit të Agjencisë” pra detyrat bazë mbi të cilën mbështetet puna e Agjencisë, hartohet dhe miratohet nga Drejtuesi i Institucionit ndërsa Përshkrimet e Punës të cilat në thelb janë derivat i kësaj rregullore dhe rregullojnë proceset e punës miratohen prej organit epror, ndërkohë që duhet të ishte krejt e kundërta.

Në rregulloren aktuale, Titullari i institucionit përcakton jo vetëm detyrat por gjithë veprimtarinë e funksionale përfshirë masat disiplinore të punonjësve, llojet dhe procedurat për dhënien e tyre. Përcaktimi, hartimi, miratimi dhe zbatimi i detyrave funksionale nga vet institucioni përbën në parim një “konflikt interesi” i cili mund të ndikoj në paanshmërinë dhe objektivitetin gjatë kryerjes së detyrës zyrtare referuar përcaktimeve të ligjit nr. 9131, date 8.9.2003 “Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike” por jo vetëm. Miratimi i rregullave të brendshme të veprimtarisë duhet të bazohet rregullisht në dispozitat e ligjit nr. 90/2012 datë 27.09.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” neni 29 “Rregulloret e brendshme” pika 2 e tij. *Më hollësisht trajtuar në faqet nr 20-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

1.1 Rekomandimi: Nga ana e AKBPM, referuar VKM nr. 24, datë 14.01.2015, pika 3 gërma dh) e tij, ti kërkohet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për propozimin e ndryshimeve të nevojshme në këtë vendim, për miratimin nga organi epror të të gjithë rregullave të brendshme të funksionimit dhe sjelljes, konform përcaktimeve të ligjit nr. 90/2012.

Menjëherë

B. MASA ORGANIZATIVE

1- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore në muajin Nëntor 2018 kishte filluar procesin e transferimit të veprimtarisë së saj pranë Institutit të Shëndetit Publik si rrjedhojë e nisjes së rikonstruksionit dhe shtesës të objektit ku ushtrohej veprimtaria. Ky transferim i aktiveve është shoqëruar dhe ka evidentuar disa problematikat të cilat trajtohen si më poshtë.

a. Institucioni nuk rezulton të ketë përmbushur detyrimin e tij për inventarizimin vjetor për periudhën ushtrimore viti 2018 si përpara transferimit ashtu dhe pas tij, në kundërshtim me përcaktimet e UMF nr. 30 datë datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar, pika 74 dhe 75 i tij. Ndërkohë që procesi i inventarizimit për vitin ushtrimor 2019 kishte nisur në muajin Janar 2020 sipas Urdhrit të Titullarit nr. 4 dhe nr. 5 datë 08.01.2020, finalizimi i këtij procesi është realizuar në muajin Gusht 2020, kur institucioni është rikthyer pjesërisht në objektin e rikonstruktuar, pra pas rreth 7 muajsh përtej afatit të parashikuar fillimisht. Zvarritjet dhe zgjatjet në kohë të procesit të inventarizimit, cenojnë besueshmërinë e procesit si dhe krijojnë rrisht në mirëmenaxhimin e aktiveve të njësisë.

b. Evidentohet se, transferimi i aktiveve në kuadër të ristrukturimit nga AKBPM te Instituti i Shëndetit Publik dhe anasjelltas, nuk është shoqëruar me dokumentacion të nevojshëm si, procesverbale, listë aktivesh të zhvendosura sipas datave, mjetet e transportit të përdorura, oraret e lëvizjes, personat shoqërues, Fletë-ngarkesa, etj. Mungesa e tyre, pavarësisht faktit se në inventarizimin e fundit të kryer nga institucioni nuk rezultojnë diferenca materiale, ka krijuar mosdokumentim të procesit dhe mungesë të gjurmës së auditimit, në kundërshtim me kerkesat e ligjit

nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 12 pika 3 pika dh) dhe f) si dhe përcaktimet e Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar, pika 34, 36, 51 e tij.

Evidentohet se, hartimi i rregullave dhe procedurave të miratuara nga Titullari lidhur me procedurat për marrjen në ngarkim, ruajtjen, mbrojtjen dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike është një hap i domosdoshëm, i cili nevojitet për të përmirësuar cilësisht procesin në funksion të ruajtjes dhe dokumentimit të tyre, si dhe garantimit të efektivitetit të kontrolleve të brendshme. Kjo referuar ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 8 pika ç) dhe ë), si dhe përcaktimet e Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar, pika 5,6 e vijues të tij. *Më hollësisht trajtuar në faqet nr 12-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

1.1 Rekomandimi: Nga ana e AKBPM, të merren masat e nevojshme për kryerje të paktën një herë vit të procedurave të plota të inventarizimit si dhe për grupe të veçanta aktivesh të kryhen inventarizime më të shpeshta me qëllim verifikimin e saktësisë së veprimeve të kryera nga njësia dhe eliminimin e abuzimeve apo keqpërdorimeve të mundshme.

Në vijimësi

1.2 Rekomandimi: Titullari i AKBPM, të hartoj rregullore të veçantë në të cilën të evidentohen qartë procedurat, për marrjen në ngarkim, ruajtjen, mbrojtjen dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike, për të siguruar mirëmenaxhimin e aktiveve dhe eliminuar keqkuptimet mbi përgjegjësinë materiale.

Brenda datës 31.03.2021

2- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, AKBPM është institucion përgjegjës, për kontrollin dhe analizimin e barnave, për të garantuar vendosjen në treg të barnave të sigurta, cilësore dhe efikase për popullatën. Njësia përgjegjëse në AKBPM për kryerjen e analizave mbi barnat është “Sektori i Laboratorit të Kontrollit”. Referuar të dhënave të këtij sektori për një mbi numrin e analizave të kryera nga institucioni gjatë një periudhë disa vjeçare, rezultoi se, nga 498 analiza të kryera në vitin 2014, numri i tyre në vitin 2018 ka arritur në 169 të tilla me një tkurrje të konsiderueshme me rreth 60% të tyre. Ndërkohë për vitin 2019 regjistrohen vetëm 68 analiza ose rreth 13.6% e analizave të realizuara në vitin 2014. Pra me një numër mjaft të vogël analizash krahasuar me periudhat e sipërpërmendura. Analiza e fundit në këtë sektor regjistrohet në muajin Tetor 2019. Pas kësaj periudhe institucioni nuk ka kryer më analiza dhe puna e sektorit në këtë drejtim bazë është paralizuar tërësisht. KLSH në auditimin e kryer nga Departamenti i Performancës në KLSH në AKBPM gjatë vitit 2019, me objekt “Cilësia dhe Siguria e Barnave në Rrjetin e Hapur Farmaceutik dhe Shërbimin Spitalor” veç aspekteve të tjera ka evidentuar gjithashtu problematikën mbi numrin e ulët të analizave të kryera nga institucioni, ndërkohë që kryerja e tyre në vijim ka stopuar. Për periudhën vitet 2019 dhe në vijim institucioni ka ushtruar veprimtarinë në ambientet pranë Institutit të Shëndetit Publik si rrjedhojë e procesit të rikonstruksionit të godinës së vet. Më tej ngjarjet e jashtëzakonshme si tërmeti i 26 Nëntorit dhe Pandemia COVID-19 shpallur në fund të muajit Mars 2020 kanë patur gjithashtu ndikimin e tyre negativ në situatën mbi ambientet dhe veprimtarinë e stafit. Megjithatë, mungesa e analizave në afatgjatë ka ndikime të rëndësishme në ruajtjen e shëndetit të popullatës dhe për këtë institucioni përpara procesit të zhvendosjes dhe në vijimësi duhet të ishte treguar më i kujdesshëm në garantimin e vijueshmërisë së punës së laboratorit dhe përmbushjen e detyrimit institucional mbi analizimin e barnave. *Më hollësisht trajtuar në faqet nr 20-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

2.1 Rekomandimi: Nga ana e AKBPM, të merren masat e nevojshme për rinisjen e punës së laboratorit të kontrollit, për të garantuar vendosjen në treg e barnave të sigurta, cilësore dhe efikase për popullatën dhe përmbushjen e detyrës funksionale të institucionit.

Menjëherë

3- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, në problematikat e evidentuara në AKBPM mbi mungesën e “Përshkrimeve të Punës” të miratuara, stafit të lartë drejtues, mangësitë mbi menaxhimin e aktiveve, ndërprerjen e kryerjes së analizave mbi barnat, nuk evidentohet roli mbikëqyrës i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si organi epror, referuar kjo dispozitave të ligjit nr. 90/2012 datë 27.09.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” neni 22 pika 1, si dhe neni 23 pika 1 e tij. Konstatohet gjithashtu se, megjithëse Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 184 datë 09.03.2016 “Për përcaktimin e rregullave për ushtrimin e kontrollit për veprimtarinë e agjencisë kombëtare të barnave dhe pajisjeve mjekësore, në zbatimin e detyrave dhe ushtrimin e përgjegjësive nga kjo agjenci”, ka miratuar krijimin e “Njësisë së Posaçme” për kontrollin periodik dhe sa herë të shihet e nevojshme të AKBPM, prej më tepër se 4 (katër) vitesh nga miratimi i këtij vendimi, MSHMS nuk rezulton ta ketë bërë efektive duke ushtruar kontrolle me këtë strukturë, në kundërshtim me parashikimet në këtë vendim.

Sa më lartë, situata paraqet nevojën imediate për përmbushjen e rolit të MSHMS si organ epror në mirëfunksionimin institucioneve, realizimin e objektivave të miratuar, ligjshmërinë dhe përshtatshmërinë e veprimeve të tyre administrative, administrimin e burimeve njerëzore, ekzekutimin e buxhetit, administrimin e pasurive dhe menaxhimin financiar. *Më hollësisht trajtuar në faqet nr 20-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

3.1 Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të merren masat e nevojshme për të bërë funksionale këtë strukturë dhe për të përmbushur kërkesat e Vendimit të Këshillit të Ministrave.

Brenda datës 31.03.2021

3.2 Rekomandimi: Nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të merren masat e nevojshme për plotësimin e organikës së AKBPM me personelin e nevojshëm konform strukturës së miratuar dhe bazës ligjore përkatëse.

Brenda datës 31.03.2021

C. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFIÇENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1- Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, AKBPM është institucion përgjegjës, i cili ka për kompetencë kontrollin cilësor të barnave për të garantuar vendosjen në treg e barnave të sigurta, cilësore dhe efikase për popullatën. Njësia përgjegjëse në AKBPM për kryerjen e analizave mbi barnat është “Sektori i Laboratorit të Kontrollit”. Referuar të dhënave të këtij sektori për një mbi numrin e analizave të kryera nga institucioni gjatë një periudhë disa vjeçare, rezultoi se, nga 498 analiza të kryera në vitin 2014, numri i tyre në vitin 2018 ka arritur në 169 të tilla me një tkurrje të konsiderueshme me rreth 60% të tyre. Ndërkohë për vitin 2019 regjistrohen vetëm 68 analiza ose rreth 13.6% e analizave të realizuara në vitin 2014, pra me një numër mjaft të vogël analizash krahasuar me periudhat e sipërpërmendura. Analiza e fundit në këtë sektor regjistrohet në muajin Tetor 2019 por më pas institucioni nuk ka vijuar kryerjen e tyre dhe puna e sektorit në këtë drejtim bazë është ndërprerë tërësisht. Në vijim, punonjësit janë ngarkuar me detyra plotësuese mbi përgatitje materiale mbi procesin e akreditimit i cili pavarësisht vlerës së shtuar që sjell, nuk justifikon moskryerjen e analizave mbi barnat, që është objekti kryesor i punës së veprimtarisë së sektorit. Vlera e shpenzuar nga institucioni për 18 punonjësit pjesë e “Sektorit të Laboratorit të Kontrollit”, në fond page dhe kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për periudhën Janar 2019-Gusht 2020 llogaritet në vlerën rreth **26.3 milion lekë**, e cila në mungesë të përmbushjes së detyrës kryesore të punës së këtij sektori në analizimin e barnave, përbën shpenzim të kryer jo në përputhje me parimet e efektivitetit, efiçencës, dhe ekonomicitetit të fondeve publike. *Më hollësisht trajtuar në faqet nr 20-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

1.1 Rekomandimi: Nga ana e AKBPM, pavarësisht procesit të akreditimit, të merren masat e nevojshme për rinisjen e punës së laboratorit për të garantuar vendosjen në treg e barnave të sigurta, cilësore dhe efikase për popullatën duke garantuar gjithashtu përdorimin me efektivitet dhe efikasitet të fondeve buxhetore.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE

-Mbështetur në ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar nenet 37, e vijues , VKM nr. 24 datë 14.01.2015 “Për Miratimin e Strukturës dhe Mënyrës së Funkcionimit e Organizimit të Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore” i ndryshuar, ***i rekomandohet*** Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, që nëpërmjet strukturave përkatëse, të analizoj dhe vlerësoj të metat, mangësitë si dhe përgjegjësitë individuale të punonjësve të AKBPM, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit me qëllim nisjen e procedurave të nevojshme administrative për dhënien e masave disiplinore përkatëse.

E. VLERËSIMI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE

Kontrolli i Lartë i Shtetit do të ndjek me vëmendje të veçantë dhe do të vlerësoj marrjen e masave, nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për zbatimin e rekomandimeve të dërguara dhe reflektimin e tyre sa i përket, garantimit të barnave të sigurta dhe cilësore në treg, mbikëqyrjes institucionale, plotësimin dhe përmirësimin të akteve ligjore mbi të cilat bazohet veprimtaria, në përputhje me parimet e ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit të fondeve publike.

F. TË TJERA

Problematikat e konstatuara në këtë auditim tematik, për vetë rëndësinë e tyre, do të jenë objekt verifikimi edhe në auditimet e plota që KLSH do të zhvilloj në vijim, pranë Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore. Ky vendim përcillet në formë rekomandimi në subjektin e auditimit.

K R Y E T A R

Arben SHEHU